

PERMBAJTJA E RAPORTIT

I PASQYRA E BILANCIT

II PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

III PASQYRA E FLUKSIT MONETAR

IV PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

V INFORMACION I PERGJITHSHEM

VI POLITIKAT KRYESORE KONTABEL

VII SHENIME MBI LLOGARITE VJETORE

EKSPERTE KONTABEL TE RREGJISTRUAR

Vullnetare Çela

Silvana Gjikhima

Adresa: Rruga Komuna e Parisit Tirane

Adresa: BUDI 324/1

Licence nr. 153 date 30/03/2006

Licence nr. 156 date 31.03.2006

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

SHOQERIA "PRODHIM VESHJE USHTARAKE" SHA

Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Tirane mars 2014

RAPORTI I AUDITOREVE TE PAVARUR

Drejtuar : Aksionerit të vetëm, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes

Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë “PRODHIM VESHJE USHTARAKE” SHA,

Rr. “Muhamet Gjollësja”, Tiranë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “Prodhim Veshje Ushtarake” SHA , të cilat përbehen nga bilanci kontabel i datës 31 dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e flukseve të parave si dhe pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet, për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje të metodave kontabel të rëndësishme dhe shënime të tjera anekse.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SKK dhe Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabel; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabel të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Nderkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin tonë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedurat të përshtatshme të auditimit në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi gjithashtu ka te beje me vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe aresyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bere nga drejtimi, si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Sipas opinionit tone, me perjashtim te komenteve te paraqitura ne shenimin 7 dhe 11, Pasqyrat Financiare japin nje pamje te vertete dhe te singerte te gjendjes financiare te Shoqerise "Prodhim Veshje Ushtarake" SHA me date 31 dhjetor 2013, te rezultatit te saj financiar, dhe te flukseve te saj te parave per vitin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standartet Kombetare te Raportimit Financiar.

Eksperte Kontabel te Rregjistruar:

Vullnetare Çela
Rr. Komuna e Parisit ,
Kompleksi Kika i Ri



Silvana Gjikhima
Rruga Budi, Tirane

SILVANA GJIKDHIMA
E.K.A LICENS NR 162
NIPT K 32202008 F

Tirane me 03 mars 2014

BILANCI KONTABEL (i Axxustuar)

(te ushtrimit te mbyllur me date 31.12.2013)

(Shumat ne ALL)

	Shënime	Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012
A AKTIVET			
I Aktive Afatshkurtera			
Aktive monetare	4	369,025	420,257
Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim			
Aktive të tjera financiare afatshkurtra	5	12,975,293	14,641,082
Inventari	6	3,552,480	5,264,780
Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje			
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra			
Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		16,896,798	20,326,119
II Aktive Afatgjata			
Investimet financiare afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	98,646,677	184,769,494
Aktivet afatgjata jomateriale			
Kapital aksionar i papaguar			
Aktive të tjera afatgjata(ne proces)			
Totali i Aktiveve Afatgjata(II)		98,646,677	184,769,494
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		115,543,475	205,095,613

Shenimet shoqeruese nga 1 deri ne 14 jane pjese integrale e ketyre Pasqyrave Financiare te shoqerise SH.A "Prodhim Veshje Ushtarake" , Tirane

B DETYRIMET DHE KAPITALI		Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012
I Detyrime Afatshkurtera			
Huamarrjet			
Huatë dhe parapagimet	8	30,104,272	25,067,530
Grantet dhe të ardhurat e shtyra			
Provizionet afatshkurtra			
Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		30,104,272	25,067,530
II Detyrime Afatgjata			
Huatë afatgjata			
Huamarrje të tjera afatgjata			
Provizionet afatgjata			
Grantet dhe të ardhurat e shtyra			
Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)			
Totali i Detyrimeve (I+II)		30,104,272	25,067,530
III Kapitali			
Kapitali i rregjistruar (aksionar)	9	100,643,000	184,900,000
Primi i aksionit			
Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)			
Rezerva statutore			
Rezerva ligjore	9	95,714	96,125
Rezerva të tjera			
Fitimet(humbja) te pashpërndara	9	(4,968,042)	(1,427,661)
Fitimi (humbja) e vitit financiar	9	(10,331,469)	(3,540,381)
Totali i Kapitalit (III)		85,439,203	180,028,083
TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		115,543,475	205,095,613

Shenimet shoqeruese nga 1 deri ne 14 jane pjese integrale e ketyre Pasqyrave Financiare te shoqerise SH.A "Prodhim Veshje Ushtarake" , Tirane

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve (i Axhustuar)

(te ushtrimit te mbyllur me date 31.12.2013)

(Shumat ne ALL)

Përshkrimi i Elementëve		Shëni me	Viti raportues 31.12.2013	Viti paraardhës 31.12.2012
1	Shitjet neto			
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	10	2,469,020	4,462,105
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces			
4	Materialet dhe mallrat e konsumuara	11	(3,577,706)	(1,410,710)
5	Kosto e punës			
	Pagat e personelit	11	(6,986,423)	(6,646,189)
	Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	11	(929,594)	(886,132)
6	Amortizimi i AAM-ve			
6	Zhvlerësimet			
	Zhvlerësimet AAM-ve			
	Zhvlerësimet Inventarit			
7	Shpenzime të tjera	11	(2,281,223)	(3,922,709)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(13,774,946)	(12,865,740)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)		(11,305,926)	(8,403,635)
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara			
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet			
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	10	974,457	3,863,754
	12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata			
	12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667			
	12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669			
	12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	10		999,500
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		974,457	4,863,254
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)		(10,331,469)	(3,540,381)
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69	12		0
16	Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)		(10,331.469)	(3,540,381)

Shenimet shoqeruese nga 1 deri ne 14 jane pjese integrale e ketyre Pasqyrave Financiare te shoqerise SH.A "Prodhim Veshje Ushtarake" , Tirane

VI. PASQYRA E FLUKSIT MONETAR (i axhustuar)
(te ushtrimit te mbyllur me date 31.12.2013)

(Shumat ne ALL)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	Shenime	Viti	Viti
		raportues 31.12.2013	paraardhës 31.12.2012
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		(10,331,469)	(3,540,381)
Rregullime për:			
Amortizimin			
Humbje nga këmbimet valutore			
Të ardhura nga investimet(shitja dhe renja ne vlere e AAM-ve)			
Shpenzime për interesa			
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera		1,665,789	(1,325,563)
Rritje/rënie në tepricën inventarit		1,712,300	29,524
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		5,036,742	3,637,481
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		(51,232)	-1,198,939
Interesi i paguar			
Tatim mbi fitimin i paguar			
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		(51,232)	-1,198,939
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale			
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		1,865,406	1,386,000
Interesi i arkëtuar			
Dividendët e arkëtuar			
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese			
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner			
Hyrje nga huamarrje afatgjata			
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare			
Dividendët e paguar			
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		(51,232)	182,248
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		420,257	238,009
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		369,025	420,502

Shenimet shoqeruese nga 1 deri ne 14 jane pjese perberese e ketyre Pasqyrave Financiare te shoqerise SH.A “Prodhim Veshje Ushtarake” , Tirane

	Emertimi	Kapitali Aksionar	Primi i Aksionit	Aksionet e Thesarit	Rezervat Statutore dhe Ligjore	Fitimi i pa Shpërdarë	TOTALI
I.	Pozicioni më 31 dhjetor 2013	184,900,000			96,125	-4,968,042	180,028,083
A	Efektet e ndryshimeve në politikat kontabël (zvogelim kapitali)	-84,257,000			-411		-84,257,411
B	Pozicioni i regulluar	-100,643,000			+95,714	-4,968,042	95,770,672
1	Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit						
2	Totali i të Ardhurave dhe Shpenzimeve që nuk janë njohur në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve						
3	Fitimi neto i vitit Financiar						
4	Dividentët e paguar						
5	Transferime në rezervën e detyrueshme Statutore						
6	Emërtimi i kapitalit aksionar						
II	Pozicioni më 31.07. 2013	100,643,000			95,714	-4,968,042	95,770,672
1	Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit						
2	Totali i të Ardhurave dhe Shpenzimeve që nuk janë njohur në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve						
3	Fitimi neto për periudhën kontabël					-10,331,469	-10,331,469
4	Dividentët e paguar						
5	Emërtimi i kapitalit aksionar						
6	Aksione te thesari të riblera						
III	Pozicioni më 31 dhjetor 2013	100,643,000			95,714	-15,299,511	85,439,203

Shenimet shoqeruese nga 1 deri ne 14 jane pjese e ketyre Pasqyrave Financiare te shoqerise SH.A "Prodhim Veshje Ushtarake", Tirane

ADMINISTRATORI

Avjeri Hoxhaj



HARTUSI – FINANCIERI

Dritan Zejno

I.SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

(Te ushtrimit te mbyllur me date 31.12.2013)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM.

Shoqeria "Prodhim Veshje Ushtarake (PVU)" Sha. eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit Tirane me date 27 Janar 2009. Ajo eshte krijuar nga transformimi i ndermarrjes shteterore me te njeitin emer ne Shoqeri Aksionare.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi per tatimet dhe taksat.

Objekti i aktivitetit sipas akteve te themelimit te saj eshte "Prodhim konfeksionesh per nevoja te ushtrise dhe prodhime civile brenda dhe jashte vendit", por qe nga viti 2011 dhe ne vazhdim nuk eshte kryer asnje aktivitet tregetare sipas objektit te parashikuar.

Certifikimi Tatimor: NIPT J 61904044 J.

Kapitali themeltar eshte 100.643.000 leke, i ndare ne 100,643 kuota me vlere nominale 1,000 leke secila dhe zoterohet teresisht nga Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes.

Shoqeria i ka zyrat e saj kryesore ne Rr. Muhamet Gjollesha, Tirane.

Organi drejtues dhe vendimarrës i shoqerise eshte Keshilli Mbikqyres.

Admistratori i Shoqerise eshte Z. Avjeri Hoxhaj.

Aktualisht shoqeria ka 5 punonjes.

Forma juridike e shoqerise eshte Shoqeri Aksionare.

II. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL

2. Bazat per pergatitjen e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne te gjitha aspektet materjale, ne baze te kerkesave te percaktuara ne Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004, "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe ne parimet baze e rregullat e parashikuara ne "Standartet Kontabel te Kontabilitetit" te aplikuar nga data 01 Janar 2008.

Pasqyrat Financiare te shoqerise per periudhen 1 Janar–31 Dhjetor 2013, jane paraqitur ne nje format i cili eshte ne perputhje me Standartin Kombetar te Kontabilitetit nr.2, "Paraqitja e pasqyrave financiare".

Per zbatimin e politikave kontabel, per vleresimet, si dhe te tjere elemente te nevojshem, per pergatitjen e pasqyrave financiare te vitit 2013, jemi referuar SKK nr.1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare".

Per hartimin e pasqyrave financiare jane aplikuar politika te tilla qe sigurojne nje pasqyrim te vertete e te besueshem te pozicionit financiar, fluksit te parave dhe ndryshimeve ne kapital te njesise ekonomike.

Sipas parimeve te kontabilitetit te pranuar gjeresisht ne Shqiperi, deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese. Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren peerfitimet.

Sistemi i kontabilitetit eshte mbajtur ne program *exceli*.

Pasqyrat financiare jane individuale, jane te shprehura ne leke (ALL), e cila eshte edhe monedha kombetare. Transaksionet ne monedhe te huaj jane perkthyer ne monedhen kombetare me kursin e publikuar nga Banka e shqiperise me date 31/12/2013 perkatesisht 1 usd = 101.86 leke.

3. Permbledhje e politikave kontabel

Nje permbledhje e pjeses me te madhe te politikave kontabel te reflektuar ne deklarimet financiare jane sa me poshte :

3.1. Mjetet monetare

Aktivitet monetare perbehen nga gjendjet ne arke dhe ne llogarite bankare. Ato jane njohur ne bilanc me vleren e tyre efektive ne daten e bilancit.

3.2. Aktivitet e Qendrueshme.

Aktivitet e Qendrueshme jane vleresuar me kostot e blerjes duke zbritur amortizimin e akumuluar. Amortizimi eshte llogaritur me metoden e vleres se mbetur duke respektuar normat e amortizimit te percaktuara ne Ligjin nr.8438 " Per tatimin mbi te ardhurat" date 28.12.1998 i ndryshuar:

3.3. Aktivitet dhe Pasivet Financiare

Aktivitet dhe pasivet financiare jane njohur ne bilanc me vleren nominale te shumes per tu arketuar apo paguar.

Njohja e te ardhurave

Te ardhurat jane njohur me vleren reale te shumes per tu arketuar. Shumat e te ardhurave jane percaktuar ne baze te marreveshjeve midis njesise ekonomike dhe bleresit te sherbimit

3.4. Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara.

3.5. Tatim fitimi

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te percaktuar nga Ligj.

III.SHENIME MBI LLOGARITE VJETORE.

Aktivi i Bilancit.

Shoqëria "Prodhim Veshje Ushtarake" Sha, për vitin 2013 ka një total aktivësh për 115,543,475 lek me një rënie për 89,552,138 lek ose rreth 44 % më pak se viti i kaluar, të cilat janë investuar si vijon:

Shenimi 4

Aktive monetare

Gjendjet e mjetet monetare në bankë dhe arke, në lekë dhe monedhe të huaja, në datat 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja në 31.12.2013		Gjendja në 31.12.2012	
		Në lekë	Në valute	Në lekë	Në valute
Llogari bankare	LEK	369,025	0	420,257	-
Arka në lekë	LEK		0	0	-
Shuma		369,025	x	420,257	x

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve, në llogaritë bankare dhe në arken e shoqërisë, konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepërcat e shprehura në monedhë të huaja, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të datës 31.12.2013 të Bankës së Shqipërisë. Gjendjet e llogarive bankare sipas bankave përkatëse janë si vijon:

- Tirane Bank 0 lekë
- RZB Tirane -1,882.94 lekë
- BKT..... 370,527 lekë
- RZB Dollar..... 380.94 lekë

Nuk ka ndryshime në politikën kontabël të njohjes, vlerësimit dhe të konvertimit të veprimeve dhe gjendjeve të likuiditeteve në PF-të 2013.

Shenimi 5

Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2013 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	8,671,199	10,511,199
Nga keto analiza e klienteve		
Dega ekonomike MM	848,846	848,846
Baza Ushtarake	1,431,770	1,431,770
Divizionet ushtarake	822,942	822,942
Repartet ushtarake	4,571,106	4,571,106
Garda e republikës Tirane	1,385	1,385
Drejtoria e rendit Publik	123,864	123,864
Departamenti kontrollit Shtetit	13,501	13,501
Qendra Kulturore e Ushtrisë	32,886	32,886
Drejtoria e Burgjeve tirane	355,561	355,561
Akademia MR Tirane	15,967	15,967
Instituti topografisë Ushtarake	22,898	22,898
Qendra e Mobilizimit Tirane	7,357	7,357
Kliente të tjere	216,038	216,038
Petrol Alba sh.p.k(2011-2012)	207,078	207,078
Dita 200 (Qera 2012)		1,840,000
ekspert parapagim(2011)		
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	4,304,093	4,129,883
Nga keto analiza e kërkesave		
Paradhenie	33,145	33,145
Paga e shperblime te mbipaguara	407,157	407,157
Detyrime per raporte mjeksore	349,494	349,494
Detyrime nga kontrolli	127,150	127,150
Debitore te tjere	1,088,827	1,088,827
Te tjera kërkesa	421,992	421,992
Shteti tatim Fitimi	0	0
Tatimi mbi vleren e shtuar-e mbartu	1,451,214	1,451,214
Tatimi mbi vleren e shtuar 2013	425,114	250,904
Shuma	12,975,292	14,641,082

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme", janë pasqyruar kërkesat për të arketuar nga klientët për shitjet e mallrave e të shëbimeve të krijuar para vitit 2009. Me gjithë perpjekjet bera nga drejtimi, arketimi i tyre paraqet vështirësi, kjo dhe për faktin se pjesa dermuese e kërkesave janë ndaj entiteteve buxhetore, të cilët nuk kanë fonde për shlyerjen e detyrimeve të vjetra.

"Kërkesa të tjera të arkëtueshme" përfaqësojnë kërkesa debitore të krijuara vite më parë, të njohura si kërkesa por deri tani kanë qenë të pamundura për të arketuar.

Shenim 6 Inventari

Gjendjet e inventarit në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:

Inventari	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
(i) Lëndët e para	2,646,700	4,348,500
(ii) Prodhim në proces	76,140	86,640
(iii) Produkte të gatshme	829,640	829,640
(vi) Zhvlerësimi i inventareve		
Shuma	3,552,480	5,264,780

- Objekti "Magazine" me sipërfaqje 520 m² me aksione 20,069 me vlerë nominale 1,000 leke secila

Me Urdherin e METE-s nr.646 date 25 /07/2013 "Per zvogelimin e kapitalit te SHA PVU" eshte bere zvogelimi i AQT-ve ,ku efekti i vleresimit ne ulje eshte ne total 64,188,00 leke, ne menyre te detajuar eshte si vijon:

- Objekti "Reparti Kepucari" me sipërfaqje 1,913 m² me aksione 100,643 me vlerë nominale 1,000 leke secila

Gjithashtu gjate vitit 2013 me urdher te METE-s nr. 155 date 08/03/2013 per transferim aktivi drejt shkolles se mesme "Karl Gega" jane transferuar Aktive afatgjata si vijon:

- Makineri pajisje 228,000 leke
- Pajisje zyra 45,568 leke

Gjate vitit 2013 me urdher te METE-s nr. 5206/2 date 01/07/2013 kane dale jashte perdorimi aktive afatgjata si vijon: .

- Makineri pajisje 1,237,500 leke
- Inventar ekonomik(pajisje zyra) 92,280 leke
- Mjete tarnsporti 262,058 leke
- Duke qene se te gjitha aktivet afatgjata kane desinacion per shitje dhe transferim nuk eshte llogaritur amortizim per vitin 2013.
- Gjithashtu eshte videntuar nje problematike lidhur me raportin e ekspertes vleresuese znj. Violeta Haloci e cila ka perllogaritur gabim vleren e Tokes dhe Nderteses . Per kete problematike eshte derguar dhe nje shkrese METE-s me nr. 31 date 11/07/2013 per sistemim kapitali.

Shenimi 8

Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2013 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2013	31	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Huatë dhe parapagimet			
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	6,833,591		6,833,591
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	45,985		464,332
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	2,078,631		1,078,268
(iv) Detyrime te tjera	21,146,065		16,691,339
(v) Hua të tjera			0
(vi) Parapagimet e arkëtuara	0		0
Shuma	30,104,272		25,067,530

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel te llogarive analitike te mbajtura per çdo furnitor.

“Të pagueshme ndaj punonjësve” perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2013 per pagat e paguara te vitit 2008 ne vleren 45,985 leke.

“Detyrimet tatimore dhe te sig.shoqerore” perbehen nga:

- Detyrimi per sigurimet shoqerore e shendetsore..... 557.055 leke
- Tatimi mbi te ardhurat personale..... 1.521.576 leke
- Totali** **2,078,631 leke**

“Detyrime te tjera” perbehet nga:

- Detyrim per Qera(70% METE).....20,556,248 leke
- Detyrime per taksa locale (taksa e pasurise).....589,817 leke
- Totali** **21,146,065 leke**

SHENIMI 9.

KAPITALET E VETA

Kapitali aksionar i Shoqerise, eshte 100,643,000 pas zvogelimit te tij sipas urdherit te METE nr. 606 date 01.07.2013

dhe te urdherit tjeter te METE-s nr. 646 date 25/07/2013 “Per zvogelimin e kapitalit te shoqerise “Prodhim veshje ushtarake Sh.a Tirane”.

Me 31.07.2013 ai është 100.643.000 leke, i ndare në 100.643 aksione me vlerë nominale 1.000 leke /aksioni. Aksionet zotërohen nga aksionari i vetëm, Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës.

Fitimi (humbja) e vitit financiar

Shoqëria ka dalë me humbje për vitin ushtrimor në shumën 10,331,469 leke.

Humbja e vitit të kaluar në shumën 4,968,042 leke është kapitalizuar në "kapitalin aksioner".

Shënimi 10.

Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) të biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Te ardhurat		
Te ardhurat nga ankandet	186,500	1,471,295
Te ardhurat nga qerata	7,508,400	8,860,295
Te ardhura nga kamatvonesat		332,722
Grante shfryt. (financiare në PASH)		999,500
Te ardhurat të tjera (rivlerësim tatimor bashkia)	974,457	3,863,754
Pjesëmarrja e llogaritur e METE në qera (-70%)	-5,225,880	-6,202,207
Shuma	3,443,477	9,325,360

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme.

Te ardhurat kryesore të ushtrimit vijnë nga dhënia me qera ndërtësive dhe ambienteve të shoqërisë. Aktualisht janë në zbatim tre kontrata qeraje afatgjata të lidhura nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës mbi bazën e VKM-se Nr.1712 "Për dhënie me qera ose enfiteozë të pasurive shtetërore", dy me afat 10 vjeçar dhe një me afat 20 vjeçar, dhe dy kontrata të lidhura ndërmjet "PVU Sha" dhe "Eko Studio Projek", "Edna Farma", si më poshtë:

- Mali-HD 354,900 leke/muaj
- H&E 95,000 "
- Dita 2000 230,000 "

Keto te ardhurat janë pasqyruar sipas shumave të faturuara qiramarrësve. Ndarja e tyre është bërë 70% derdhen për METE-në dhe 30% e te ardhurave mbahet për shoqërinë kjo sipas VKM-ne 529, datë 08.06.2011.

Tek të "ardhurat e tjera" shuma 974,457 leke, ka ndikuar faljet nga ligji i tatimeve për taksat e bashkise për vitin 2013.

Shenim 11

Shpenzimet e veprimtarise

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.

"Materjalet dhe mallrat e konsumuara" ne shumen 3,577,706 leke i referohet koston se magazinimit per AAM dhe Inventarin e shitur gjate vitit 2013.

"Kostoja e punesimit", page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit si shpenzim dhe detyrime. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2013 jane treguar ne pasqyren perkatese.

"Shpenzime te tjera" ne shumen 2,281,223 leke, perbehen si vijon:

• Shpenzime te tjera, auditim ekspert etj.	1,266,735 leke
• Taksa bashkie	576,640 leke
• Gjoha, penalitete	426,632 leke
• Komisione bankare	11,216 leke

Shenimi 12

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin.

Shoqeria per vitin 2013 ka rezultat negativ pra si fitimi tregtar dhe ai tatimor eshte negativ nuk llogaritet tatimin mbi fitimin.

Shenimi 13

Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Vazhdon shitja e inventarit nepermjet ankandeve.